



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS KLINË

Numri i lëndës: 2023:270754

Datë: 15.02.2024

Numri i dokumentit: 05333151

C.nr.468/23

Gjykata Themelore Pejë-Dega në Klinë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtaren Fllanza Hashani, me bashkëpunëtoren profesionale Albulena Morina-Lulaj, në çështjen juridike kontestimore të paditësve: K. D. dhe M. D. , që të dy nga fshati D... , Komuna Klinë, të cilët i përfaqëson i autorizuari N. H. , avokat në P... , kundër të paditurve: A. D. dhe N. D. , që të dy nga fshati D... , Komuna Klinë, me bazë juridike: pengim posedimi, jashtë seancës gjyqësore me datë 12.02.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

HEDHET E PASAFATSHME, padia për pengim posedimi, me shenjen 468/23, e datës 06.12.2023, e parashtruar nga paditësit K. D. dhe M. D. , kundër të paditurve: A. D. dhe N. D. .

A r s y e t i m

Paditësit përmes të autorizuarit të tyre në këtë gjykatë kanë parashtruar padi me datë 06.12.2023, kundër të paditurve A. D. dhe N. D. , me bazë juridike pengim posedimi, me të cilën ka kërkuar nga gjykata që të vërtetohet pengimi i paditësve dhe të detyrohen të paditurit që menjëherë ta ndërprejnë, çdo veprim në ndryshim të gjendjes dhe ta kthejnë në gjendje të mëparshme siç ka qenë.

Gjykata pas shqyrtimit paraprak të padisë dhe thënieve të paraqitura në padi nga paditësit, ka vlerësuar se padia e paraqitur nga ana e paditësve është e pasafatshme.

Me nenin 114 të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore (në tekstin e mëtejme LPDTS), parashihet se: "*Kërkesa mund të parashtrohet vetëm në afatin prej 30 (tridhjetë) ditësh, pasi që*

poseduesi e merr dijeninë lidhur me privimin apo pengimin e posedimit të tij. Kërkesa shuhet pas kalimit të një viti nga privimi ose pengimi i posedimi”.

Gjykata konstaton se paditësit me datë 05.11.2023, kanë rënë në dijeni lidhur me pengim posedimin duke ia prishur rrethojën me mrezh të gjelbër dhe duke ja qel temelin rreth megjes e deri të shtëpia e paditësve, ndërkaq mbrojtjen gjyqësore e kanë kërkuar vetëm me datë 06.12.2023, kur edhe kanë parashtruar padinë në gjykatë, dhe atë pas kalimit të afatit 30 ditor. Afati i tillë është afat prekluziv, me konsekuencë humbjen e të drejtës për paraqitjen e një kërkesë të tillë.

Andaj, gjykata duke u bazuar në thëniet e paditësve në padi, si dhe bazuar në nenin 114 të LPDTS-së, vendosi që padinë e paditësve ta hedhë poshtë si të pasafatshme, pasi që në këtë rast paditësit kanë lëshuar afatin ligjor, për të kërkuar mbrojtje gjyqësore sipas bazës juridike të pengimit të posedimit.

Sidoqoftë, paraqitja e padisë për pengim të posedimit, nuk ndikon në autorizimet ligjore për të ngritur një padi pronësore eventuale, apo madje edhe për të kërkuar mbrojtje ligjore për një pengim eventual të mëpastajmë që mund të ndodh.

Nga se u tha më lartë e konform dispozitave ligjore nga neni 391 pika f) të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK)-së dhe neni 114 të LPDTS-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Nga se u tha më lartë, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE PEJË-Dega në Klinë
Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil
C.nr.468/23 i datës 12.02.2024.

Gjyqtarja
Fllanza Hashani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.